



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008, nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.07.2021 merr këtë

V E N D I M

PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E STATUTIT TË QENDRËS KULTURORE TË PRISHTINËS

I. MIRATOHET Vendimi për plotësim-ndryshimin e Statutit të Qendrës Kulturore të Prishtinës.

II. a) Sipas pikës I të këtij vendimi, plotësim-ndryshimi nënkupton ndryshimin e nenit 10, "Përbërja dhe mandati i Këshillit Drejtues", ndryshohet pika 1 dhe 2, me tekstin si në vijim:

1. Këshilli Drejtues i QKP-së përbëhet nga 7 anëtarë, me mandat 4-vjeçar;
2. Një anëtar nga Qendra Kulturore e Prishtinës, tre anëtarë nga Drejtoria e Kulturës ose institucionet vartëse, dhe 3 anëtarë nga Shoqëria Civile;

b) Ndryshimin e pikës 1 të nenit 4, me tekstin si në vijim:

Qendra Kulturore e Prishtinës e ka selinë në Prishtinë.

III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Drejtoria e Kulturës.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-144324/21, më 22.07.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

